



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201701557/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Sugjerojmë rishikimin e dokumentacionit të shtetasit A.Sh për vazhdimin e grupit të parë të invaliditetit, si një rast specifik në kushtet e ndodhura për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.*

Drejtuar: **Kryetarit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë
Për Punë (KMCAP)**

ELBASAN

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur kërkesë shtetasja A.S, me anë të së cilës kërkon ndërhyrjen tonë institucionale pranë KMCAP-it Elbasan për dhënien e mundësisë për vazhdimin e grupit të invaliditetit të vëllait të saj të sëmurë, *shtetasit A.Sh.*

Sipas shpjegimeve të parashtruara, vëllai i tij, i datëlindjes 1953, në moshën 19 vjeçare, në vitin 1972 është aksidentuar dhe ka mbetur i paralizuar. Që në atë kohë, pra prej 45 vitesh, është përfitues i grupit të parë të invaliditetit. Ai gëzon statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik, "*Përgjithmonë*".

Në muajin Prill të vitit 2015, ka shkuar për t'u kuruar në Gjermani. Aty përkujdeset nga i vëllai i tij, i cili është caktuar edhe kujdestar. Fillimisht është shtruar në spital dhe më pas është trajtuar sa në spital dhe në banesë sociale.

Duke qenë se nga ana e komisionit tuaj ishte deklaruar në vijimësi me grup të parë të invaliditetit, përgjithmonë, ankuesja ka dorëzuar dokumentacionin përkatës të vëllait të tij, me qëllim për të vazhduar grupin e invaliditetit te përfituar prej vitesh, por ka marrë përgjigje se duhet që shtetasi A.Sh të jetë prezent në komision.

Nga dokumentacioni bashkangjitur ankesës, konstatojmë se, sipas shkresës së datës 31.05.2017 të Dr.med.P.Weber/F.Schlenzog në Mynih, ndër të tjera shprehet si më poshtë:

“Zoti A.Sh është pacient që vizitohet në shtëpi dhe bazuar në sëmundjet ekzistuese nuk është në gjendje të largohet nga banesa vetë në mënyrë të pavarur....

...është shfaqur një shkallë Decubitus III, e cila duhej të ishte trajtuar vazhdimisht që prej Tetorit të vitit 2015 dhe vetëm tani është në një madhësi prej rreth 1 cm x 1.5 cm me një thellësi prej 0.5 cm....

...bazuar në lëvizmërinë apo lëvizjet thelbësore të kufizuar ekziston një Simptomatikë dhimbjesh e përsëritur shumë e theksuar në rajonin e LWS, e cila me NSAR duhet patjetër të terapeutizohet (apo të bëjë terapi). Për më tepër, ekziston si nevojë e një shoqërimi psikoterapeutik...

..Kthimi nuk është i nevojshëm..”

Gjithashtu edhe sipas vërtetimit të po këtij doktori, lëshuar më datë 13.01.2017, renditen një sërë sëmundjesh të rënda, nga të cilat vuan shtetasi A.Sh:

-Dëmtime të rënda me Tetraplegji dhe paralizë nëp të 4 gjymtyrët

-Dekubitus sakral Grada IV që prej vitit 2010

-Ç'rregullim neurogjjen i zorrëve-fshikëzës

-Sindrom ii i dhimbjes kronik lumbal dhe cervikal pseudoradikular

-Myelomalatia HWS

-Stenozë e kanalit spinal L4/5

-Sarcoidoza e nyjeve limfatike mediastinale

-Kontraktim i veshkës djathtas

...Zoti A.Sh është gjithnjë në shtrat dhe ka dhimbje kronike gjithnjë të përsëritshme.”

Duke qenë në këto kushte, i sëmuri nuk mund të paraqitet pranë atij komisioni për të përfituar grup invaliditeti, pasi kjo do t'i krijonte mjaft probleme gjëndjes shëndetësore të tij.

Sa më sipër, duke ditur gjëndjen shëndetësore të shtetasit Albert Shëngjergji, e cili nuk del për herë të parë në komision, por e ka përfituar prej 45 vitesh grupin e parë të invaliditetit nga komisioni juaj mjekësor dhe në pamundësi objektive për t'u paraqitur personalisht,

SUGJEROJMË:

Rishikimin e dokumentacionit të shtetasit A.Sh për vazhdimin e grupit të parë të invaliditetit, si një rast specifik në kushtet e ndodhura për shkak të gjëndjes së tij shëndetësore.

Lutemi ta shqyrtoni me precedence dhe të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Bashkangjitur ju dërgojmë kopje të:

- Vendimit nr.4 datë 03.06.2003 të KMCAP-it Elbasan
- Shkresës së datës 31.05.2017 e Dr.med.P.Weber/F.Schlensoq, Mynih
- Vërtetimit mjeksor të datës 13.01.2017 .

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI